

KOLEGJI “UNIVERSUM”

RREGULLORE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SIGURIA NË PUNË

Kolegji “Universum”

*Njësit akademike: Prishtinë,
Ferizaj, Gjakovë dhe Prizren.*

Në harmoni me Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarave dhe ambientit të punës Nr.2003/19, Ligjin e punës Nr.03/L-212, si dhe në bazë të statutit të Kolegjit “Universum” neni 6 paragrafi (1) dhe dy (2), Këshilli Drejtues shpallë këtë:

RREGULLORE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SIGURIA NË PUNËS

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1. Me këtë rregullore, Kolegji Universum përcakton sistemin e mbrojtjes të objekteve nga fatkeqësitë nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera të natyrës vis-majori (**fuqisë-madhore**), dhe sigurinë në punë, gjatë procesit të punës në Kolegjin Universum.

Neni 2

2.1 Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit, përmban programin, planifikimin dhe organizimin e stafit në Kolegjit Universum për mbrojtje nga zjarri dhe shpëtim nga zjarri dhe evakuimin e stafit nga këto rrethana.

2.2 Ky sistem dhe program ndryshohet dhe plotësohet në vazhdimësi, sipas ndryshimeve dhe standardeve që përcaktohen me legjislacionin shtetëror në fuqi.

Neni 3

3.1 Detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë e zjarrit dhe nga fatkeqësitë e tjera, janë:

- a) zbulimi, përcjellja e rreziqeve nga fatkeqësitë e zjarrit dhe fatkeqësitë e tjera;
- b) parandalimi dhe kujdesi maksimal i stafit të Kolegjit Universum;
- c) lajmërimi, alarmimi dhe informimi i punonjësve për rreziqet e mundshme;
- d) arsimimi dhe aftësimi i punonjësve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë;
- e) organizimi i mbrojtjes dhe i gatishmërisë emergjente;
- f) vetëmbrojtja, vetë ndihma, ndihma reciproke ndërmjet personelit.

Neni 4

4.1 Realizimi i mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë e zjarrit dhe nga fatkeqësitë e tjera, realizohet në bazë të dispozitave dhe standardeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 5

5.1 Kolegji Universum, punonjësve të vet i siguron mjete dhe pajisje të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

5.2 Kolegji Universum, siguron trajnimin e vazhdueshëm të stafit për përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit, dhe trajnime për evakuim në rastet e zjarrit në hapësirat e Kolegjit Universum.

Neni 6

6.1 Të gjitha këto pajisje kundër zjarrit të siguruar nga Kolegji Universum, duhet të përdoren sipas standardeve dhe kushteve të plotësuara për përdorimin e tyre.

6.2 Asnjë punonjës nuk guxon ti përdorë këto pajisje dhe mjete, pa ndonjë aftësim dhe trajnim për përdorimin e tyre.

Neni 7

Dëmtimet e punonjësve

Të gjitha dëmtimet shëndetësore gjatë ndonjë situatë të krijuar emergjente në Kolegjin Universum, këto dëmtime do të kompensohen nga Kolegji Universum, sipas ligjit të punës, dhe ligjit për siguri në punës.

Neni 8

Plani i evakuimit (emergjent) nga fatkeqësitë e zjarrit

8.1 Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, Kolegji Universum nxjerr planin e evakuimit të stafit në rastet e fatkeqësive nga zjarri dhe fatkeqësive tjera, i cili planë hartohet sipas standardeve dhe këshillave nga personat e autorizuar për situatë të tilla.

8.2 Plani i evakuimit i përcjellit çdo punonjësi në momentin e themelimit të marrëdhënies së punës, dhe i njëjti duhet të zbatohet në përpikëri nga stafi dhe me kujdes maksimal.

8.2 Për arsye të natyrës së veprimtarisë së punës në Kolegjit Universum, ky planë i dërgohet dhe i elaborohet (shpjegohet me veprime, demonstrim fizik), stafit akademik të angazhuar dhe studentëve të Kolegjit Universum, para çdo filli të vitit akademik.

Neni 9

9.1 Të gjitha objektet e Kolegjit Universum, janë të mbuluara me pajisje kundër zjarrit, të cilat punëdhënësi është i obliguar ti testoj sipas kohës së përcaktuar për testimin e tyre, dhe afatit të përdorimit të tyre.

9.2 Kutitë e ndihmës së parë janë të ekspozura në të gjitha objektet e Kolegjit Universum.

Neni 10

Siguria në Punë

10.1 Vendi i punës ka kuptimin e hapësirës punuese ku kryhet veprimtaria e punës, sipas nenit një (1), të Ligjit për siguri në punë.

10.2 Siguria në punë dhe mbrojtja e shëndetit të punësuarave është pjesë integrale dhe shumë e rëndësishme e organizimit të punës dhe procesit të punës, dhe punëdhënësi do të ndërmarrë paraprakisht të gjitha masat e nevojshme dhe të domosdoshme për sigurinë e shëndetit të punësuarve.

Neni 11

Të drejtat e punësuarave për siguri në punë

11.1 Të gjithë punonjësit e Kolegjit Universum, i gëzojnë të drejtat për siguri në punës, të cilat janë të përcaktuara me këtë rregullore dhe me ligjin për siguri në punë, dhe ligjin e punës.

11.2 Punonjësi që ka marrëdhënie pune të rregullt pune, dhe kontratë valide të punës, i gëzon të drejtat nga siguria në punës, sipas paragrafit 10.3.

11.3 Të drejtat themelore nga siguria në punë:

- a. Ambient të përshtatshëm të punës;
- b. Kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë;
- c. Informimin paraprak për rreziqet në punë, në rast se punonjësit i paragjykohet kanosje nga rreziqet e caktuara;
- d. Udhëzimet nga punëdhënësi për rreziqet në punë.

Neni 12

Të gjitha dëmtimet gjatë procesit të punës të punësuarave nga pa kujdesia apo mos aplikimi i udhëzimeve për mbrojtje, apo nga neglizhenca e tyre, nuk paraqesin përgjegjësi për punëdhënësin.

Neni 13

Hyrja në Fuqi

13.1 Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për mbrojtje nga zjarri dhe siguri në punë, nxirren në mënyrë dhe sipas procedurave të parapara me statutin e Kolegjit Universum.

13.2 Rregullorja hynë në fuqi nga dita e shpalljes në rrjetin e brendshëm kompjuterik të Kolegjit Universum, dhe në tabelat informuese të Kolegjit Universum, e në tërësi aplikohet **nga 1 janari 2008**.

13.3 Rregullorja nënshkruhet nga Kryetari i Bordit Drejtues të Kolegjit Universum.

Kolegji Universum
Kryetari i Bordit Drejtues
Suat Berisha

